

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHAHU ENERGY”Sh.p.k

Sot, me date 03.02.2025 une I nenshkruari

-Elis Shahu lindur ne Skrapar (Çorovodë) me 21.07.1984 shtetas shqipetar, banues ne shqiperi, identifikohet me nr ID I40721059P, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008.”Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” kam vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjewis te Kufizuar te emeruar **“SHAHU ENERGY” sh.p.k**(me poshte referuar si “Shoqeria”,duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti I kesaj shoqerie do te rregullohet nga Statuti I saj, I cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi dhe bashkangjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri I shoqerise eshte; **“SHAHU ENERGY” sh.p.k**

Neni 2

(1)Selia e shoqerise ndodhet ne adresen:- Qarku Berat, Rrethi Skrapar, Bashkia Skrapar, Rruga “Arkitekt Kasëmi” nr.82, hyrja 1, Kodi postar 1420.

(2) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon|:elis.shahu@yahoo.com
Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3

-Kohezgjatja e shoqerise do te jete 10 vjet dhe fillon qe prej dates sse regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

-Prodhim I energjise elektrike nga parqet fotovoltaike, eolike dhe hidrocentralet. Blerja dhe shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike nga njesite e prodhimit te subjekteve te licensuar tek konsumatorët. Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shtetterore brenda dhe jashte vendit. Konsulence per tregtimin e energjise elektrike, per disbalancat energjise elektrike. Perfaqesim tregtar dhe agjensi. Blerje trojesh prona te tjera. Per aktivitetin e saj Shoqeria mund te kryej veprime me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe te administroje, bleje, shese, ose te mare me qira, te kete interesa ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera, konsorciume te themeluara ose ne themelim e siper, qe kane objekt te ngjashem te veprimtarise me objektin e shoqerise ose objekti I tyre I sherben qellimit te realizimit te objektit te shoqerise, te angazhohet ne hapjen e stacioneve te plazhit, hoteleri, turizem dhe aktiviteteteve te rekreacionit. Montim panelesh diellor per biznese dhe familjare. Cdo veprimtari tjeter qe nuk ndalohet me ligj.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **100 000** (njqind mije) leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues Z. Elis Shahu: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme prej **100 000** Leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi I ortakeve do te jete: 100000 leke ne para.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi I kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta respektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit ten je shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) Trashegimise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeer te parashikuar me ligj;

Pjeset e kapitalit themeltar jane ligjerisht te trasferueshme ndermjet ortakeve, persa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltare jane ligjerisht te transferueshme me rruge trashegimnie.

Neni 8

Organi vendimarrës

Asambleja e ortakeve eshte organi I vetem vendimarrës I shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi I vetem vendimarrës I shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve, perjashtimi nga e drejta e votes dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 9

Administrimi

Administrator I shoqerise **Elis Shahu** lindur me 21.07.1984 shtetas shqipetar, banues ne shqiperi, identifikohet me nr ID I40721059P, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, I zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertet

Viti financiar I shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxierien e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese ta dorzoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 11

Prishja- riorganizimi I shoqerise

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”I ndryshuar.

Neni 12

Akti I Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

Elis Shahu

